STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 10 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NENSHKRUAN URDHERIN EKZEKUTIV PER TE LEJUAR QE FARMACISTET, EMT-TE DHE DENTISTET TE NDIHMOJNE NE BERJEN E VAKSINAVE TE TETANOZIT NE ZONAT E PREKURA NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Departamentet shëndetësore të shtetit dhe të qytetit këshillojnë njerëzit që të bëjnë një vaksinë tetanozi për të parandaluar infektimin e mundshëm

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se ka nënshkruar një Urdhër Ekzekutiv që do t'a bëjë më të lehtë që njerëzit në zonat e prekura nga Uragani Sendi (Sandy) të vaksinohen kundër tetanozit për të parandaluar infektimet që mund të rezultojnë nga ekspozimi ndaj bakterieve të tetanozit gjatë veprimtarive të pastrimit pas stuhisë. Sipas Urdhërit, farmacistët do të lejohen që të bëjnë vaksinat e tetanozit në vendet e tyre të biznesit dhe teknikët mjekësorë të emergjencave (EMT-të) dhe dentistët do të jenë në gjendje që të ndihmojnë departamentet shëndetësore të qytetit ose të qarkut në administrimin e vaksinave të tetanozit.

"Mbrojtja e shëndetit dhe siguria e banorëve të Nju Jorkut ka qënë përparësia jonë kryesore përpara, gjatë dhe pas Uraganit Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Eshtë e rëndësishme që njerëzit që kryejnë punën e pastrimit pas stuhisë të ndërmarrin të gjitha përkujdesjet shëndetësore të nevojshme, përfshirë bërjen e një vaksine të tetanozit nëse nevojitet. Urdhëri do të ndihmojë që t'a bëjmë procesin më të lehtë dhe më të shpejtë për ata në zonat e prekura nga stuhia."

Për shkak të mundësisë së pësimit të prerjeve të thella ose plagëve kur pastrohen mbeturinat, kryhen detyra që përfshijnë kontakt me dhe ose materiale të pista ose bëhen riparime në shtëpi pas Uraganit Sendi (Sandy), njerëzit duhet të ruhen ndaj infeksionit të tetanozit. Reaguesit ndaj emergjencave, vullnetarët dhe banorët që punojnë në projekte të riparimit, ndërtimit dhe pastrimit duhet të kontrollojnë që të sigurohen se janë imunizuar ndaj tetanozit brenda 10 viteve të fundit; nëse nuk kanë azhornuar imunizimin ose nuk janë të sigurtë në lidhje me datën e vaksinimit të fundit të tyre që përmbante tetanozin, ata duhet të marrin një mbrojtje nga tetanozi.

Departamenti i Shëndetësisë i Shtetit të Nju Jorkut dhe Departamenti i Shëndetit dhe Higjenës Mendore i Qytetit të Nju Jorkut u bëjnë thirrje njerëzve që të kontaktojnë fillimisht siguruesin kryesor të kujdesit shëndetësor të tyre për të marë një vaksinë të mbrojtes nga tetanozi. Nëse siguruesi kryesor i shëndetit të tyre nuk është në punë ose nuk mund të shkojnë tek zyra e siguruesit kryesor të shëndetit të tyre,

individët duhet të kontaktojnë farmacinë vendore të tyre ose departamentin shëndetësor vendor për të pyetur në lidhje me marrjen e një vaksine mbrojtje. Shumë farmaci në zonat e prekura janë gati për të siguruar këto vaksinime. Banorët në Qytetin e Nju Jorkut mund të telefonojnë 311 për të gjetur një vend të vaksinimit.

Këtë javë, Departamenti i Shëndetësisë i Shtetit dërgoi gjithsej 5,000 doza të vaksinës së tetanozit, difterisë, kollës së mirë (Tdap) në qarqet e mëposhtëm: Qarku Safolk (Suffolk) 1,500 doza; Qarku Nasau (Nassau) 1,500 doza; Qarku Roklend (Rockland) 1,000 doza dhe Qarku Uestçester (Westchester) 1,000 doza. Qyteti i Nju Jorkut ka si vaksinën Tdap, ashtu edhe Td (tetanozin dhe difterinë).

Tetanozi është një infeksion i shkaktuar nga bakterie që janë të pranishme në pluhur, dhe ose pleh e hyn në trup nëpërmjet plagëve me shpim ose prerjeve. Pas hyrjes në trup, bakteriet mund të prodhojnë helme që mund të shkaktojnë kontraktime të dhimbshme të muskujve në qafë dhe bark, që shpesh karakterizohen si "mbyllje nofullash" dhe mund të dëmtojnë frymëmarrjen. Nëse lihet pa u kuruar, tetanozi mund të jetë vdekjeprurës.

Përveç ndjekjes së udhëzimeve të sigurisë për të parandaluar plagosje gjatë veprimtarive të pastrimit ose ndërtimit, të gjitha plagët dhe prerjet duhet të lahen krejtësisht me sapun dhe ujë. Kujdes mjekësor duhet të kërkohet për plagët me shpim dhe gërvishtjet. Njerëzit që pësojnë plagosje dhe nuk ka patur një mbrojtje nga tetanozi gjatë pesë viteve të kaluara duhet të rivaksinohen si pjesë e kurimit për plagosjen.

Si rezultat i imunizimit të përhapur gjerë, tetanozi është një sëmundje e rrallë në SHBA. Të gjithë fëmijët që ndjekin çerdhet në Shtetin e Nju Jorkut, si dhe ata që hyjnë në klasat K-12 kërkohet sipas ligjit të Shtetit që të marrin një sërë imunizimesh për tetanoz, difteri dhe kollën e mirë. Një vaksinë mbrojtje (Tdap) kërkohet gjithashtu për fëmijët e lindur pas 1 janarit 1994, që do të rregjistrohen në klasat 6-11.

Vaksina mund të jetë e efektshme pasi një person pëson një plagë, por në disa raste mund të kërkohet imuno globulinë tetanozi. Rekomandohet një mbrojtje tetanozi në formën e një vaksinimi Tdap (tetanoz, toksoid difterie dhe acelular i kollës së mirë) dhe ajo do të sigurojë mbrojtje kundër dy sëmundjeve të tjera. Një mbrojtje Td (tetanoz dhe difteri) gjithashtu mund të përdoret. Tdap preferohet ndaj Td kur është i disponueshëm dhe do t'u sigurojë të rriturve me mbrojtje kundër kollës së mirë, e cila ka parë një rritje në numrin e rasteve të njoftuara anembanë shtetit këtë vit.

Informacion shtesë mbi tetanozit është i disponueshëm në:
http://www.health.ny.gov/diseases/communicable/tetanus/fact_sheet.htm/.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418